



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2619/2025
Data: 21.05.2025

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e katër -IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.04.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Përfaqësuesi i OSB-së, **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025.
3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .
4. Propozim –Vendim për ndarjet e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025” –Edicioni i tretë”.
5. Kërkesë për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025.
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- propozoj që në rend të punës të hynë rishqyrtimi i aktit normativ, vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në teritorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Kryesuesi thekson:- propozimin e z. Nexhmedin Daci e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025.
3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .
4. Propozim –Vendim për ndarjet e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025” –Edicioni i tretë”.
5. Kërkesë për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025.
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Rishqyrtimi i aktit normativ, vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në teritorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me NR. 08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2025 është në lartësi prej 3,615,457.00 €. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe shtesa 2,188,542.00 €, Mallra dhe shërbime 584,500.00 €, Shpenzimet komunale 94,000.00 €, Subvencione dhe transfere 143,000.00 €, Shpenzime kapitale 605,415.00 €. Totali i buxhetit është në shumë prej 3,615,457.00 €. Ndërsa buxheti përfundimtar është 3,807,629.14 €, ku në këtë shumë përfshihen: Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,275,738.00 €. Projektioni i të Hyrave Vetanake në shumë prej 339,719.00 €. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej 15,923.01 €. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 176,135.45 €, 5. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 113.68 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - mars 2025 është në shumë prej 681,517.35 €. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 560,691.90 € apo 99.85% nga Buxheti i alokuar dhe 25.62% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 96,823.42 € apo 16.17% nga Buxheti i alokuar dhe 14.81% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Komunale për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 23,202.03 € apo 24.68 % nga Buxheti i alokuar dhe 24.68 % nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 800.00 € apo 3.90 % nga Buxheti i alokuar dhe 0.56% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Nga kategoria buxhetore Shpenzime Kapitale, përgjatë TM1 të vitit 2025 dhe 2024, nuk ka pasur shpenzim. Projektioni i të hyrave vetanake 2025 është në shumë prej 339,719 €, Realizimi është në shumë prej 37,239.12 €, ndërsa për vitin 2024 realizimi ka qenë në shumë prej 111,374.83 € pra në këtë vit kemi inkasuar 74,135.71 € më pak se në tre mujorin e vitit të kaluar.

Sherif Berisha thekson:- bazuar në projektin e të hyrave vetanake për vitin 2025 që janë në shumë prej 339,719.00 € shihet që realizimi është në shumë prej 37,329.12 € apo 11 % , në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprakë shihet që keni një ngecje prej 298 % dhe nuk shohë ndonjë iniciativë për të hyrat vetanake. Sipas drejtorive lidhur me inkasimin e të hyrave vetanake për periudhën janar –mars 2025, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2024 keni ngecje në këtë tre mujorë. Administrata e përgjithshme ka ngecje minus 447,43% , Buxhet dhe financa ka ngecje minus 90.76 % , Zhvillim Ekonomik ka ngecje minus 870.07 % , Urbanizmi ka ngritje plus 34.5 % , arsim apo çerdhe ka ngecje minus 1.77% , shëndetësia ka ngritje 3,53.81%. Faqe katërmbëdhjetë aty keni paraqitur një tabelarë që keni paraqitur buxheti total të vitit 2025 në shumë prej 3, 399,278 €, ndërsa kolona tjetër është buxheti i flokuar në shumë prej 3,811,674.42 € . Si ka mundësi që me qenë alokimi më i madh se sa buxheti. Të kategoria mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike faqe 18 , në kuadër të kësaj kategorie kërkojmë të dimë se çfarë shpenzime janë në kodin 13410 shërbimet e arsimit dhe trajnimit ku është vlera 4000 € dhe kodi 13430 shërbime të ndryshme shëndetësore në shumë prej 40000 € , kërkoj sqarim. Te faqja 21 te kategoria sipas kodeve ekonomike shihet se janë shpenzuar te energjia elektrike një shumë e mjeteve 18,906 .73 € , pse është ky dallim i madh në krahasim me periudhën e njëjtë të tre mujore. Faqe 22 te kategoria ekonomike shpenzime kapitale shihet se shpenzimi është zero.

Lindita Ballazhi thekson:- një faktorë kryesorë që të hyrat vetanake janë më të vogla në këtë tre mujorë është se kompania Sharrcem vitin e kaluar në tre mujorin e parë e ka kryer taksën për ushtrim të veprimtarisë që është në shumë prej 60 000 € , ndërsa për gjatë këtij viti këtë taksë për ushtrim të veprimtarisë nuk e ka kryer në tre mujorin e parë, po ashtu ka edhe disa drejtori që kanë inkasuar më pak të hyra në krahasim me vitin e kaluar, në administratë shumë certifikata janë bërë pa pagesë apo është ndryshuar çmimorja për certifikata, po ashtu edhe te tatimi në pronë ende nuk janë inkasuar faturat të cilat janë shpërndarë. Sa i përket buxhetit të alokuar kjo ka ndodhur për gjatë vitit aktual siç mund ta vëreni te tabela në faqe katërmbëdhjetë nëse i shikoni të gjitha kategoritë buxhetore mund ta vëreni vetëm te kategoria paga dhe shtesa është shuma e planifikuar edhe e alokuar dhe është një shumë e caktuar që e ka alokuar Ministria e Financave –departamenti i thesarit sepse kategoria e pagave do të alokohet për çdo tre mujor. Te kodi e ekonomik i shërbimeve shëndetësore janë paguar pagesa për marrëveshjen që e kemi me “Isalmik Reliefin” për angazhimin e stafit shëndetësorë. Shpenzimi elektrik është mi i lartë në këtë periudhë se në krahasim me periudhën e vitit të kaluar , është diferencë më e madhe se gjatë viti të kaluar kanë mbetur disa obligime të cilat nuk kanë mundur të ekzekutohen dhe janë ekzekutuar gjatë këtij viti. Te investimet kapitale gjatë tre mujorit të vitit 2025 nuk kemi asnjë shpenzim, po ashtu edhe gjatë tre mujorit të vitit 2024 nuk ka asnjë shpenzim.

Hisni Luri thekson:-sa i përket trajnimeve në drejtorinë e arsimit janë trajnime me organizatën Shpik që është lënda e kodimit. Trajnimi tjetër është në bashkëfinancim me fakultetin e edukimit dhe OJQ Toka dhe Bashkimi Evropian ne i kemi ndarë vetëm tre mijë euro për pesëmbëdhjetë mësimdhënësit të cilët janë trajnuar të nxënit përmes përvojës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- nga pasqyrat financiare të vitit 2023 i kemi pesë të gjetura. Çështja e parë është vonesa në pagesën e obligimeve financiare. Kjo e gjetur është pjesërisht e zbatuar. Ka raste të cilat pagesa nuk kanë mund të realizohen brenda afatit ligjor. Kjo ka rrjedh për shkak të lëndëve përmbartimore të cilat kanë rrjedh nga kontrata kolektive dhe mjetet janë ekzekutuar pa aprovimin rrjedhimisht. Çështja e dytë ka të bëjë me zotimi i mjeteve dhe urdhërblertjet në SIMFK pas pranimit të faturave. Edhe kjo është pjesërisht e zbatuar ku kemi raste ku nuk dihet vlera e faturës si psh: furnizim me derivate për automjetet zyrtare paraprakisht nuk mund të bëhet zotimi pa ardhur fatura sepse nuk dihet vlera e saktë e furnizimit. Çështja e tretë ka të bëjë me dobësi në menaxhimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale, por kjo e gjetur është në proces pasi që Epasuria është funksionalizuar, mirëpo janë disa pasuri që kanë mbetur pa u evidentuar. Çështja e katërt ka të bëjë me rritje e llogarive të arkëtueshme. Është pjesërisht e zbatuar pasi që ne kemi bërë njoftime për pagesën e detyrimeve tatimore, kemi ofruar lidhjen e kontratave me debitorët për pjesën e detyrimeve me këste por normalisht në disa raste nuk kemi mundur i inkasojmë të gjitha llogaritë e arkëtueshme. Çështja e pestë është mos themelimi i njësisë së auditimit të brendshëm. Kjo e gjetur është e pazbatuar gjatë vitit 2024 dhe po vazhdon edhe në vitin 2025 e që edhe gjatë këtij viti nuk do të zbatohet pasi që kemi bërë kërkesa të shtuar numër të stafit por nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk kemi marr përgjigje pozitive kështu që nuk kemi mundur me planifikuar njësinë e auditimit të brendshëm

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Propozim –Vendim për ndarjet e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025” –Edicioni i tretë”.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- vlera e përgjithshme e mjeteve financiare për mbështetje “Ditët e Kulturës dhe Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar Hani i Elezit 2025-Edicioni i Tretë” është në shumë prej 25,000.00 € dhe do të merren nga këto Nën-programe buxhetore dhe nga këto kategori, si vijon: Zyra e Kryetarit (16035), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 11,000.00 €, Shërbimet Kulturore (85035), kategoria mallra dhe shërbime (130), shuma prej 8000.00 €, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (19675), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 500.00 €, Administrata (16335), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 5000.00 €, Turizmi (48075), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 500.00 €.

Arbenita Bajramaliu thekson:- për realizimin e aktiviteteve për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025” –Edicioni i tretë” shuma totale e mjeteve financiare është 25,000.00 € . Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- është një shumë prej 25,000.00 € me mundësi ndryshimi por vitin e kaluar ka qenë një shumë tjetër, ndërsa kjo shumë është e madhe. Kërkoj sqarim se pse këto mjete duhet të merren nga drejtoritë e tjera siç e keni sqaruar në propozim vendim dhe pse drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nuk ka bërë planifikim, vetë fakti që ju merri mjete nga drejtoritë e tjera për realizimin e këtij aktivitete flet shumë për keq menaxhimin tuaj si në planifikim ashtu edhe në shpenzime të buxhetit të vitit 2025. Pse nuk është planifikuar si drejtori për me pasur buxhetin e vetë e pse me na u përcjell në kuvend në këtë formë.

Mehmet Ballazhi thekson:- prej KPF-së u njoftova që keni kërkuar informacion për aktivitet, ideja është e sqarimeve , në komunë është i njëjti buxhet dhe varësisht prej nevojave që paraqiten në i bartim. Në bazë të përvojë se është edicioni i tretë i festivalit mbarë kombëtarë dhe e dimë përfaqësisht se sa mjete shpenzojmë dhe shuma 25000 € është tepër pak për me realizuar ndoshta ashtu siç kishim pasur dëshirë. Në këtë vit ndoshta mendojmë me mbajtur natën e fundit në hapësirë të jashtme e që ajo do të ketë një kosto shtesë, pra gjithmonë mund të ketë ndryshime për shkak të specifikave apo veprime që nga një herë nuk mundesh me i planifikuar fiks e për atë është bërë ky planifikim që me pasur hapësirë për me i bërë pagesat e mos me mbetur borxh. Sa i përket keq planifikimit apo keq klasifikimit është çështje e auditorit që ka me i parë këto dokumente dhe pastaj mund të jep rekomandime. Sa i përket planifikimit të drejtorisë për këto mjete, buxheti kur është miratuar është miratuar si buxhet i komunës së Hanit të Elezit pastaj bartjet dhe alokimet bëhen sipas nevojave që na paraqiten dhe nuk jemi tu dal përtej buxhetit të miratuar por jemi brenda buxhetit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PRPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR DITËT E KULTURËS DHE FESTIVALIN MBARËKOMBËTARË HANI I ELEZIT 2025 –EDICIONI I TRETË

5. Kërkesë për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- kërkesën për bilancin pashpenzuar për vitin 2024 në vitin 2025 është në shumë prej 170,771.67 € . prej të hyrave vetanake që kanë qenë të realizuara për vitin 2024 në shumë prej 317,021.00€, prej të cilave janë shpenzuar vetëm 155,136.00 €, ndërsa të pa shpenzuara kanë mbetur 161,885.00 € dhe prej fondit 22 të vitit 2024 shuma e bartur ka qenë 133,030.00 €, që është shpenzuar vetëm 124,134.00 € de të pa shpenzuara kanë mbetur 8887.00 €, pra fondi 21 dhe fondi 22 i vitit 2024 në total është 170,771.67 € që këto mjete kërkojmë që ti bartim në këto nën-programe dhe kategori buxhetore si vijon. Në kategorinë buxhetore mallra dhe shërbime: Buxhetimi (17535), kodi funksional (0112), shuma prej 2,000.00€, Parandalimi dhe inspektimi i zjarrit (18444), kodi funksional (0721) shuma prej 5,860.96 €, Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 5000.00 €, Arsimi parafillorë –çerdhja (92890), kodi funksional (0911) shuma prej 3000.00 €. Në kategorinë buxhetore subvencione dhe transfere Arsim dhe Shkencë: Administrata (92175), kodi funksional (0980) shuma prej 5000.00 €. Në fund të javës së kaluar përmbarusët i kanë marr disa mjete financiare te disa projekte kapitale të cilat janë në procedura të tenderimit dhe ato projekte kanë mbetur pa shumë konsiderueshme të mjeteve dhe për me plotësuar atë zbrastirë është dashur që t'i bëjmë disa ndryshime për me i kompletuar mjetet për projektet që janë në procedura e sipër kategorinë buxhetore shpenzime kapitale: Planifikimi urban dhe inspekcioni (66480) në shumë prej 88,771.67 € në këto projekte kapitale: ndërtimi i trotuareve për këmbësorë në Han të Elezit në rrugën Adem Jashari, Udha e Shkronjave Driton Loku , Paldenicë me kod (53370) në shumë prej 5,500.00 € , shtrimi me kupëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat në shumë prej 41,693.00€, asfaltimi i rrugës Eksodi 99 –Hani i Elezit me kod (55037) në shumë prej 8000.00 € , asfaltimi i rrugës Nehat Curri lagja Curri –Dermjak me kod (55048) në shumë prej 33,578.67 €. Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050) kodi funksional (0721) shuma prej 1,139.04 € në projektin rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së në Han të Elezit dhe AMF-së në Gorancë me kod (45647) në shumë prej 1,139.04 €. Arsim dhe Shkencë : Administrata (92175) kodi funksional (0980) në shumë prej 60,000.00 € në projektin : investime në pajisje të IT –së në shkollat SHML Dardania , SHFMU Ilaz Thaçi, SHFMU Veli Ballazhi dhe SHFMU Kështjella e Diturisë me kod (56091) në shumë prej 60 000.00 €.

Sherif Berisha thekson:- të hyrat vetanake nga përshkrimi që i keni pasur për vitin 2024 janë në shumë prej 317,021.00 € dhe prej tyre keni shpenzuar 155,136.00 € apo në përqindje 49 % , ndërsa të pashpenzuara kanë qenë 161,885.00 € apo 51 % e shumës . Për çfarë arsye ka mbetur kjo shumë e mjeteve financiare e pa shpenzuar dhe cilat ishin shkaqet dhe arsyet që nuk janë shpenzuar. Te shpërndarja e mjeteve që keni bërë kërkoj sqarim se çfarë projekte keni paraparë për turizëm. Në arsim rregullimi i infrastrukturës shkollore, ndërsa nëse shikohet tabela dy te shpërndarja e mjeteve nuk gjenden ato mjete a është ndonjë gabim apo ku qëndron problemi.

Lindita Ballazhi thekson:- janë shpenzuar mjetet financiare në shumë prej 155,136.00 € pasi që ne e kemi pasur edhe fondin 22 për gjatë viti 2024, mjetet e bartura nga viti 2023 në vitin 2024. Shuma e atyre mjeteve të cilat janë bartur për gjatë vitit 2024 është në shumë prej 133,30.00 € dhe kjo është shpenzuar po thuaj se e gjitha 8887.00 € që këto mjete së bashku me fondin 21 të vitit 2024 do të barten së bashku për gjatë viti fiskal 2025. U përmendën projektet në kuadër të drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe turizmit dhe te drejtorisë së arsimit ju njoftoj që është materiali i vjetër të cilin e keni pranuar në KPF , ndërsa sot këtë të cilin ua dorëzuam në kopje fizike është material i ri dhe me shumën të reja që disa projekte janë hequr për shkak të arsyes që e potencova më herët se përmbaruesit i kanë marr mjetet financiare e projektet që janë në faza gati në përfundim të tenderimit ne normalisht që duhet ti kompletojmë mjetet financiare në mënyrë që të bëhet nënshkrimi i kontratave për me i vazhduar punimet.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA PËR BARTJEN E BILANCIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- duke i parë shifrat të të hyrat për periudhën janar- mars 2025 është një shumë prej 667,455.97 €, ndërsa shpenzime janë më shumë se sa inkasimi. Në kuadër të shpenzimeve kisha dashur me ditë pozicionin gjashtëmbëdhjetë për shpenzime higjienike, kërkoj të dijë se çka është pastruar me këtë vlerë në këtë tre muajorë.

Refet Kalisi thekson:- shumën për shpenzimet higjienike është një vlerë shumë e madhe është mirë me dhënë sqarim se ndoshta kanë mundur edhe shpenzimet e viti të kaluar me hyjë në këtë vit. Sa i përket kompanisë nuk kam asnjë vërejtje për shkak se është duke bërë një punë shumë të mirë, por me paga punëtorët e kompanisë janë shumë poshtë dhe është mirë që edhe prej komunës me ndarë mjete që atyre punëtorëve me ua ngritur pagat.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk mundet me u shpenzuar diçka nëse nuk ke të hyra por mund të shënohet si borxh është mirë që pyetja të parashtrahet ndryshe apo vetëm me kërkuar sqarime. Çështjen e rritjes së pagave e kemi diskutuar me kryeshefin e kompanisë dhe po besoj që nga një qershori do t'i marrin me ngritje pagat duke i para inkasimin e të hyrave në raport me shpenzimet dhe pastaj me marr vendim saktë se sa do të jetë ngritja. Sa i përket shpenzimit të mjeteve financiare për pastrim ndoshta vitin e kaluar nuk ka ndodhë pastrimi te ndonjë rrugë e në këtë vit ka ndodhë dhe nuk është traditë që i njëjti send mundet me ndodhë në vitin e kaluar dhe mund të ndryshojnë.

Sherif Berisha thekson:- si anëtarë i komisionit të aksionarëve në takimin të ciline kemi pasur jemi dakorduar që me i ngritur pagat prej muajit qershor

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

7. Rishqyrtimi i aktit normativ, vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në teritorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- në muajin mars kemi marr vendim për monumentet e trashigimisë natyrore por Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar që të rishqyrtohet ky vendim dhe ne i kemi bërë ndryshimet në bazë të rekomandimeve që i ka dhënë kjo Ministri.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RYSHQYRTIMI I AKTIT NORMATIV, VENDIM PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË STUDIMEVE DHE EVIDENTIMIT TË VLERAVE TË TRASHIGIMISË NATYRORE NË TERITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT TË PROPOZUARA NGA INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

10.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- Kryetari e ka premtuar për me blerë një pronë dhe nuk e di a është paguar dhe a është në plan me u bërë ndërtimi i shkollës. Te rruga e Gorancës kanë filluar punimet dhe është mirë që kanë filluar punimet dhe po u mbyllke rruga për qarkullim, a është ndonjë rrugë alternative dika tjetër.

Mehmet Ballazhi thekson:- e kemi sqaruar disa herë për çështjen e parcelës dhe jemi në bashkëpunim të ngushtë me fondacionin që është i krijuar për blerjen e asaj pronë dhe është gati se në fund sipas informatave që i kam, është gati në përfundim e sipër të pagesës dhe nuk është e imja për me dhënë ndonjë informacion se ligjërisht nuk jam për me dhënë dhe nëse kërkon diçka mundeni prej fondacionit me kërkuar informata konkrete . Është e vërtetë që e mbështesë këtë projekt dhe aktivitete kam bërë gjithçka për me mbështetur këtë projekt sepse është i rëndësishëm për qytetarët. Fillimisht ka me u ndërtuar një çerdhe që na i ka premtuar Ministria e Arsimit. Në momentin që do të kryhet pagesa do ta njoftojmë Ministrinë e Arsimit që me filluar ndërtimin e shkollës dhe një fushë sportive që do të jetë projekt i kushtueshëm. Sipas takimit që e kemi pasur me kompaninë që është duke i kryer punimet ata kanë potencuar që rreth një muaj e gjys mund të bllokohet rruga për shkak të rrezikut që mund të shkaktohet nga shembja e dheut dhe gurëve. E di që kanë punuar diçka në rrugën e vjetër për me bërë gati por se kur e ndalojnë nuk kemi ndonjë njoftim. Ne jemi duke bërë përpjekje se nëse mbyllet ajo rrugë të jetë afati sa më i shkurtë dhe nëse janë mundësit edhe mos me mbyll.

Sherif Berisha thekson:- në takimet të cilat mbahen për siguri është mirë çështja e vjedhjeve për shkak se kanë filluar me u rrit se ndoshta keni informacion që në fshatin Gorancë janë vjedh një kope dele edhe pse janë organet e sigurisë por është mirë që të bisedohet. Kam dëgjuar që edhe kabllot kamerat dhe rrymës janë pre në atë pjesë.

Hanumshahe Dibrani thekson:- lagjja “Imer Vila” që dy dytë nuk ka ujë .

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket vjedhjeve dëshira është e gjithëve që me i parandaluar dhe me i ndal por kjo është dukuri jo vetëm në Kosovë po në tërë Botën. Në KKSB i diskutojmë këto dukuri dhe në raportet që i kemi paraqitur në Kuvend edhe vjedhjet edhe çështjen e vandalizmit dhe këto janë kapacitete me mundësit tona, ndërsa çështja e tjetër është e organeve të rendit të hetuesisë për me i zhvilluar procedurat. Ne e njoftojmë policinë çoftë për prerjen e kabllos që ka ndodhë. Për çështjen e kopesë së deleve nuk kam informacion. Për çështje të mungesës së ujit nuk kam informacion dhe këtë informacion mundeni me marr te kompania 'Bifurkacioni' për shkak se ata janë përgjegjës.

Refet Kalisi thekson:- nga OJQ kur të paguhet prona a do ti bartet Komunës prona. Policia është mirë me dal në patrullim edhe në këmbë e jo vetëm me vetura se me të vërtetë ka probleme. Vjen motorri me shpejtësi prej njëqind në orë zhurmë e madhe është, kamerat ekzistojnë dhe askush nuk merr masa, ulëset i kanë dëmtuar dhe nuk do të thotë që policia me qëndruar rregullisht aty por me pasur një interesim.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështja e parë është përfundimi i pagesës dhe nga momenti që do të kryhet pagesa prona kalon në emër të fondacionit pastaj kalon në emër të komunës për realizimin e projektit. Policinë nuk mundemi me detyruar për në takimet që i kemi të rregullta ju rekomandojmë për me i kryer patrullimet edhe në këmbë dhe aq sa e kanë obligim policia dy fish e kemi edhe ne me u marr me fëmijët tanë, edhe mësimdhënësit nëpër shkolla, imamët nëpër Xhamia, rrethi shoqërorë sepse nuk mundemi vetëm me zhvendosur problemi por ne duhet të bëjmë parandalim dhe zgjidhje të problemit dhe të këtyre dukurie.

Malik Berisha thekson:- është mirë që me dhënë një afat të caktuar kompania kur ta ndale rrugën e jo me potencuar një mujo e gjysmë sepse një herë kemi nejtë gjashtë muaj para do viteve dhe përsëri nuk u bë zgjidhje

Zaim Bela thekson:-stacioni policorë ka dal në objekt të ri dhe objekti që të cilin e ka shfrytëzuar policia a është në mbikëqyrje të dikujt.

Mehmet Ballazhi thekson:- kompania e cila është duke i kryer punimet e kam lutur që rrugën mos me bllokuar fare dhe kur ata mendojnë që duhet me ndaluar sigurisht që do ta japin një afat të caktuar. Sa i përket objektit policia e vijës së gjelbërt e kanë nga një roje deri sa ne ta bëjmë pranim dorëzimin që me ditur se çfarë asete kanë lënë dhe çka mundemi ne me marr përsipër. Me kryeshefin e kompanisë pastrimi e kemi diskutuar që për momentin me i dërguar mjetet e kompanisë atje dhe me caktuar një roje apo përmes kamerave do t'i shikojmë mundësitë për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:15.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

